Prishtinë, më 25 shtator 2025
Nr. Ref.:AGJ2786/25

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI216/23

Parashtrues

Hadi Bakija

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën CN. nr. 454/01 në Gjykatën Themelore në Gjakovë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hadi Bakija, nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Teki Bokshi dhe Korab Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike, por konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [CN. nr. 454/01] në Gjykatën Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës që ndërlidhet me kërkesëpadinë e tij në Gjykatën Themelore, për të cilën parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 tetor 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 tetor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI216/23] e caktoi gjyqtaren Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare raportuese, dhe përmes Vendimit [nr. KSH. KI216/23] e caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu - Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).

7. Më 13 tetor 2023, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtit i kërkoi që ta dorëzojë në Gjykatë formularin e nënshkruar të kërkesës, si dhe kopjet e vendimeve që ndërlidhen me rastin.

8. Më 16 tetor 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës të nënshkruar, por jo edhe vendimet lidhur me rastin.

9. Më 27 nëntor 2023, Gjykata i dërgoi një shkresë përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi nga ai që të sjellë dokumentet dhe vendimet që ndërlidhen me rastin e tij.

10. Më 29 nëntor 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë që ndërlidhen me rastin e parashtruesit të kërkesës.

11. Më 1 dhe 20 dhjetor 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë lidhur me rastin.

12. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi e dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

13. Më 10 shtator 2024, Gjykata kërkoi informata shtesë nga Gjykata Themelore përkitazi me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht të njëjtës i kërkoi që ta informojë

Gjykatën: (i) nga cila datë është regjistruar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore; dhe (ii) në cilën fazë të procedurës gjendet shqyrtimi i kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës.

14. Më 16 shtator 2024, Gjykata Themelore e informoi Gjykatën se lidhur me lëndën [C. nr. 454/01] kishte vendosur me aktgjykim më 5 prill 2024, ku kishte aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, dhe se lënda tash ndodhet në Gjykatën e Apelit, pasi kishte parashtruar ankesë e paditura - Komuna e Gjakovës.

15. Më 10 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, në rregullin 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe në Vendimin e Gjykatës [KK-SP 812-1/24] të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi u zgjodh Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimin e lartcekur të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtari Nexhmi Rexhepi, detyrën e Kryetarit të Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, më 30 dhjetor 2024. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 dhjetor 2024, përmes Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-2/24], gjyqtari Safet Hoxha u zgjodh Zëvendëskryetar i Gjykatës, dhe bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të lartcekur të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtari Safet Hoxha, detyrën e Zëvendëskryetarit e merr më 11 dhjetor 2024.

16. Më 23 dhjetor 2024, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, me Vendimin [nr. ref.: KK 1009/24] vendosi që gjyqtari Nexhmi Rexhepi të caktohej kryesues i kolegjeve shqyrtuese në rastet në të cilat ai më herët ishte caktuar si anëtar i Kolegjit shqyrtues, duke përfshirë edhe rastin aktual.

17. Më 30 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimin e Gjykatës [KK-SP 812-1/24] të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi e mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës, ndërsa bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Gresa Caka-Nimani e përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

18. Në të njëjtën ditë, bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit, edhe gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi e përfundoi mandatin e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

19. Më 8 janar 2025, Kryetari Gjykatës, Nexhmi Rexhepi, përmes Vendimit KSH. KI216/23, e caktoi gjyqtarin Enver Peci anëtar në Kolegjin shqyrtues, në vend të Selvete Gërxhaliu-Krasniqit, mandati i së cilës si gjyqtare kishte përfunduar më 30 dhjetor 2024. Bazuar në pikën I të vendimit të lartcekur, Kolegji shqyrtues ka këtë përbërje: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).

20. Më 23 janar 2025, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës që rasti të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e ardhshme.

21. Më 29 janar 2025, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore dhe kërkoi që ta dorëzojë dosjen e plotë të lëndës.

22. Më 3 shkurt 2025, Gjykata Themelore e njoftoi Gjykatën se dosja ndodhet në Gjykatën e Apelit sipas ankesës së ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

23. Më 4 shkurt 2025, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Apelit dorëzimin e dosjes së plotë të lëndës.

24. Më 29 prill 2025, Gjykata e Apelit dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.

25. Më 3 shtator 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë shkelje të së drejtës për nxjerrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm kohor, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

26. Bazuar në informatat dhe pohimet e parashtruesit dhe shkresat në dosjen e lëndës, rezulton se me vendim të Kuvendit Komunal të Gjakovës, parashtruesi i kërkesës ishte zgjedhur kryetar i Komisionit për çështje të strehimit të përkohshëm në kuadër komunal, dhe se në korrik 2001 i ishte ofruar kontrata në të cilën ishte përcaktuar paga prej 460 DM (marka gjermane), të cilën kontratë nuk e kishte pranuar.

27. Më 16 tetor 2001, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë kundër Komunës së Gjakovës, ku kishte kërkuar që të detyrohet Komuna e Gjakovës që parashtruesit të kërkesës në emër të ndryshimit në të ardhurat mujore t'ia paguajë shumën nga 80 DM çdo muaj, duke filluar nga 11 prilli 2001 e tutje, me kamatë ligjore nga arritja e secilit këst e deri në pagesën definitive, dhe t'ia kompensojë shpenzimet procedurale në afat prej 8 ditësh nga dita kur ky aktgjykim ta marrë formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit.

28. Më 11 prill 2002, Gjykata Komunale kishte filluar me shqyrtimin e çështjes sipas padisë së parashtruesit të kërkesës, ku kishte kërkuar nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës që në seancën e radhës ta sjellë kontratën mbi punën e ofruar parashtruesit të kërkesës.

29. Më 23 maj 2002, Gjykata Komunale mbajti seancën e radhës, mirëpo në seancë nuk kishin marrë pjesë asnjëra palë, sepse seanca ishte shtyrë për një datë tjetër.

30. Më 26 qershor 2002, Gjykata Komunale mbajti seancën e radhës, ku parashtruesi i kërkesës nuk kishte qenë prezent në seancë, dhe me këtë gjyqtarja e çështjes vendosi që të pushojë procedurën lidhur me këtë çështje juridike.

31. Më 20 nëntor 2002, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Komunale paraqiti kërkesë për vazhdimin e procedurës lidhur me çështjen.

32. Më 20 janar 2004, Gjykata Komunale mbajti seancën e radhës dhe e urdhëroi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës që gjykatës t'ia përcjellë provat, ndërsa seancën e radhës e shtyu për kohë të pacaktuar.

33. Më 28 maj 2007, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore kërkesë për vazhdimin e procedurës dhe urgjencë për caktimin e shqyrtimit kryesor.

34. Më 28 shtator 2023, Gjykata Themelore mbajti një seancë gjyqësore, gjatë së cilës konstatoi se, për shkak të ndërrimit të gjyqtarit, shqyrtimi i çështjes duhet të fillojë nga e para. Gjithashtu, gjykata miratoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për precizimin e padisë.

35. Bazuar në parashtresat e dorëzuara në Gjykatë, rezulton se më 3 tetor 2023, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore paraqiti një parashtresë, përmes së cilës precizoi kërkesëpadinë e tij, përkatësisht caktoi shumën të cilën pretendon se ia ka borxh paditësi, Komuna e Gjakovës.

36. Më 9 dhe 30 tetor 2023, Gjykata Themelore mbajti seancat e radhës.

37. Bazuar në informatën e dorëzuar nga Gjykata Themelore, Gjykata vëren se Gjykata Themelore ka vendosur lidhur me lëndën e parashtruesit të kërkesës më 5 prill 2024, dhe se lënda ndodhet në Gjykatën e Apelit në bazë të ankesës së Komunës së Gjakovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i kohëzgjatjes së procedurës në Gjykatës Themelore. Thënë këtë, thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me pretendimin e tij për mosveprim të Gjykatës Themelore për zgjidhje të çështjes së tij që ndërlidhet me diferencën në pagë.

39. Më specifikisht, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon tejzgjatje të procedurës përkitazi me padinë e tij të parashtruar në Gjykatën Themelore më 16 tetor 2002 dhe të precizuar më 3 tetor 2023. Tutje, i njëjti specifikon se: *"Edhe pse brishtësia e sistemit gjyqësor në Kosovë është e qartë, raste të këtillë nuk besoj se ka në Kosovë. Kontestet e punës janë të natyrës urgjente, ex lege. Me nenin 475 të LPK-së thuhet: "Në kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës".*

40. Parashtruesi i kërkesës thekson se: *"Kërkoj që Gjykata Kushtetuese të gjykoj kompensimin e dëmit jomaterial për shkak të dhembjeve shpirtërore si pasojë e shkeljeve të të drejtave elementare njerëzore dhe kërkoj kompensimin e shumës prej 10.000,00 euro. Këtë e kërkoj nga Gjykata Kushtetuese, pasi vendi ynë ende nuk ka nxjerr Ligj për mbrojte të të drejtave për shkak të shkeljes së të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm. [...]".*

41. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor; (iii) të detyrohet Republika e Kosovës që parashtruesit të kërkesës, në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e shkeljeve të të drejtave elementare njerëzore, t'ia paguajë shumën prej 10.000,00 euro.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[…]"

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për gjykim të drejtë)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm […]."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

42. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

43. Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[…]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

44. Gjykata më tej iu referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

45. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston tejzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [CN. nr. 454/01] pranë Gjykatës Themelore. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit, gjegjësisht tejzgjatjen e procedurës pranë kësaj instance gjyqësore, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kriterit të përcaktuar me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, përkatësisht kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor prej katër (4) muajsh.

46. Përveç kritereve të përcaktuara në Ligj, Gjykata shqyrton tutje nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:
(...)
(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

47. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara nëpërmjet paragrafit 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës.

48. Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

49. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon tejzgjatje të procedurës përkitazi me ankesën e dorëzuar në Gjykatën Themelore. Në bazë të informacionit të dhënë nga parashtruesi i kërkesës, rezulton se me vendim të viti 2001 të Kuvendit Komunal të Gjakovës ishte zgjedhur kryetar i Komisionit për çështje të strehimit të përkohshëm në kuadër komunal, dhe se në korrik 2001 i ishte ofruar kontrata në të cilën ishte përcaktuar paga prej 460 DM (marka gjermane), të cilën kontratë nuk e kishte pranuar. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë kundër Komunës së Gjakovës, ku kishte kërkuar që të detyrohet Komuna e Gjakovës që parashtruesit të kërkesës në emër të ndryshimit në të ardhurat mujore t'ia paguajë shumën nga 80 DM çdo muaj, duke filluar nga 11 prill2001 e tutje, me kamatë ligjore nga arritja e secilit këst e deri në pagesën definitive, dhe t'ia kompensojë shpenzimet procedurale, krejt në afat prej 8 ditësh nga dita kur ky aktgjykim ta marrë formën e prerë nën kërcënim të përmbarimit. Gjykata Komunale kishte mbajtur disa seanca lidhur me çështjen në fjalë, dhe se mbajtja e seancës së fundit ishte më 20 janar 2004 në Gjykatën Komunale. Më 28 maj 2007, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për vazhdimin e procedurës dhe urgjencë për caktimin e shqyrtimit kryesor në Gjykatën Komunale. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vërejti se parashtruesi i kërkesës më 3 tetor 2023 kishte bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe se lënda kishte filluar të shqyrtohej rishtazi nga një gjyqtar i ri. Po ashtu, nga përgjigjja që Gjykata ka pranuar nga Gjykata Themelore, thuhet

që Gjykata Themelore ka vendosur lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës më 5 prill 2024 duke e aprovuar atë, dhe se lënda ndodhet në Gjykatën e Apelit në bazë të ankesës së Komunës së Gjakovës.

50. Në kërkesën e tij në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës specifikon se atij i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i tejzgjatjes së procedurës që ndërlidhet me kërkesëpadinë e tij për pagimin e diferencës në pagë.

51. Andaj, Gjykata në vazhdim do të trajtojë këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe asaj të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për vendim brenda një afati të arsyeshëm

52. Gjykata fillimisht rikujton se, paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës përcakton se: *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]"*.

53. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se: "*Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]"*.

54. Bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

55. Lidhur me këtë, Gjykata tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore që përfshin por nuk kufizohet në rastet: (i) KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha,* Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović,* Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana,* Aktgjykim i 18 korrikut 2022; (iv) KI177/19, parashtrues *NNT "Sokoli",* Aktgjykim i 29 marsit 2021; dhe (vi) KI19/17, parashtrues *Fatos Dervishaj,* Aktvendim për papranueshmëri i 20 shkurtit 2018. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ-ja, duke përfshirë rastet: (i) *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (iii) *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iv) *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (v) *Mikulić kundër Kroacisë,* nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002; (vi) *Scordino kundër Italisë* (nr.1), [DhM] nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (vii) *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (viii) *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (ix) *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë,* nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; (x) *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010; dhe (xi) *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.

56. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, rezulton se: (i) përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe

procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50; *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 74; *Comingersoll kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 24; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 142; dhe rastet e Gjykatës KI06/21, cituar më lart, paragrafët 50-75; dhe KI19/21, cituar më lart, paragrafi 82).

57. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (i) kompleksiteti i rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih rastin e GJEDNJ-së: *Surmeli kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 128; dhe rastin e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafi 65), të cilat në mënyrë të përmbledhur do të elaborohen në vijim.

58. Përkitazi me (i) kompleksitetin e rastit, kjo mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen. Thënë këtë, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafët 66-67; dhe rastet e GJEDNJ-së: *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 210).

59. Përkitazi me (ii) sjelljen e palës në procedurë, nuk kërkohet nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet pala për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, megjithatë autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës; nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë procedurën në favor të tij; dhe se vetëm vonesat që i atribuohen Shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës janë: mungesa e vullnetit për të dorëzuar shkresat, e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës përpara gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih rastet e GJEDNJ-së: *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 68; dhe *Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet autoriteteve shtetërore dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih rastin e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafi 68-70).

60. Sa i përket (iii) sjelljes së autoriteteve kompetente, shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet, dhe jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe për sjelljet e institucioneve publike; gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor, gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi; përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë kjo nuk e përjashton

mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë; shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmang përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore; mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave; dhe se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra (shih rastet e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafi 71-73; dhe KI06/21, cituar më lart, paragrafi 67).

61. Sa i përket (iv) rëndësisë së e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve të cilat, për nga natyra e tyre, duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: rastet që ndërlidhen me statusin; rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga "*sëmundje të pashërueshme"* dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë*"; rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, p.sh. rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih rastet e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafi 74; dhe KI06/21, cituar më lart, paragrafi 67).

Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysh

62. Në bazë të informacionit të dhënë nga parashtruesi i kërkesës rezulton se me vendim të Kuvendit Komunal Gjakovë ishte zgjedhur kryetar i Komisionit për çështje të strehimit të përkohshëm në kuadër komunal, dhe se në korrik 2001 i ishte ofruar kontrata në të cilën ishte përcaktuar paga prej 460 DM (marka gjermane) të cilën kontratë nuk e kishte pranuar. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi më 16 tetor 2001 në Gjykatën Komunale në Gjakovë kundër Komunës së Gjakovës, ku kishte kërkuar që të detyrohet Komuna e Gjakovës që parashtruesit të kërkesës në emër të ndryshimit në të ardhurat mujore t'ia paguajë shumën nga 80 DM çdo muaj, duke filluar nga 11 prilli 2001 e tutje me kamatë ligjore nga arritja e secilit këst e deri në pagesën definitive, dhe t'ia kompensojë shpenzimet procedurale, krejt në afat prej 8 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të marrë formën e prerë nën kërcënim të përmbarimit. Gjykata Komunale kishte mbajtur disa seanca lidhur me çështjen në fjalë dhe mbajtja e seancës së fundit ishte më 20 janar 2004 në Gjykatën Komunale. Më 28 maj 2007, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për vazhdimin e procedurës dhe urgjencë për caktimin e shqyrtimit kryesor. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vërejti se parashtruesi i kërkesës më 3 tetor 2023 kishte bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe se lënda kishte filluar të shqyrtohej rishtazi nga një gjyqtar i ri. Po ashtu, nga përgjigjja që Gjykata ka pranuar nga Gjykata Themelore, thuhet se Gjykata Themelore ka vendosur lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës më 5 prill 2024, duke e aprovuar atë, dhe se lënda ndodhet në Gjykatën e Apelit në bazë të ankesës së Komunës së Gjakovës. Prandaj, pavarësisht se rasti ishte iniciuar përmes padisë në vitin 2001, i njëjti ishte duke pritur të zgjidhet nga gjykata e shkallës së parë deri më 5 prill 2024, kur Gjykata ishte informuar përkitazi me këtë rast.

63. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se rasti i parashtruesit të kërkesës është paraqitur në vitin 2001 dhe ka vazhduar të shqyrtohet edhe pas 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi, deri më 5 prill 2024, duke përfshirë periudhën më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vjet. Rrjedhimisht, kjo është periudha që do të merret parasysh nga Gjykata (shih rastin e Gjykatës: KI142/23, parashtrues Fadil Berisha, Aktgjykim i 12 shkurtit 2025, paragrafi 54).

64. Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, rasti i tij ishte trajtuar brenda afatit të arsyeshëm, në vijim do të vlerësojë (i) ndërlikueshmërinë e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

i) Ndërlikueshmëria e rastit

65. Në rastin konkret, Gjykata vëren se rasti i parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me çështje kontestimore, ku parashtruesi i kërkesës përmes padisë së iniciuar në Gjykatën Themelore kishte kërkuar që të detyrohet Komuna e Gjakovës që t'ia paguajë diferencën në pagë prej 90,00 (nëntëdhjetë) euro për periudhën kohore nga 11 prilli 2001 deri më 11 prill 2002, në shumën e përgjithshme prej 1.080,00 (një mijë e tetëdhjetë) euro me kamatë ligjore deri në pagesën definitive. Për më tepër, Gjykata vlerëson se çështjet që ndërlidhen me kërkesa për kompensim, për nga natyra edhe mund të jenë komplekse në vetvete, por jo aq të vështira për t'u zgjidhur, për shkak të ndikimit që shkaktojnë procedurat e ndërmjetme që kërkojnë edhe ekspertizë të posaçme nga ekspertë të jashtëm, e cila nuk mund të ofrohet nga gjykata përkatëse, siç është caktimi i vlerës së dëmit të shkaktuar paditësit me rastin e mospagesës së diferencës. Megjithatë, kjo nuk mund të justifikojë mosvendosjen e rastit deri në prill të vitit 2024 nga Gjykata Themelore.

ii) Sjellja e parashtruesit të kërkesës

66. Lidhur me sjelljen e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ndërmori çdo veprim procedural që ishte kërkuar nga gjykata e shkallës së parë dhe legjislacioni në fuqi për zgjidhjen e lëndës civile në kohë të arsyeshme pa vonesa të tepruara. Gjykata rikujton se padia në Gjykatën Komunale në Gjakovë ishte parashtruar më 16 tetor 2001, për të cilën janë zhvilluar disa seanca, por pa një vendim përfundimtar. Çështja ishte riaktivizuar në vitin 2007 dhe që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës e deri në veprimin e fundit të ndërmarrë nga Gjykata Themelore, kanë kaluar më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vjet. Në këtë kontekst, duke pasur parasysh veprimet e ndërmarra nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vlerëson se palët në procedurë ishin të vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe se të njëjtit nuk kishin përdorur mënyra për të shtyrë procedurën.

67. Prandaj, duke u bazuar në veprimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka ndikuar në vonesat e gjykatës.

iii) Sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore

68. Gjykata, në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve kompetente, përkatësisht të gjykatës së shkallës së parë, thekson se kjo instancë gjyqësore, që nga inicimi i padisë, nuk kishte marrë asnjë vendim meritor për çështjen, madje nuk kishte arritur të caktonte as seancë shqyrtuese për t'iu dhënë palëve mundësinë e dëgjimit. Për pasojë, Gjykata rikujton se vonesat në zgjidhjen e çështjes kanë kontribuar në zvarritjen e vendimmarrjes për këtë çështje.

69. Gjykata Themelore, më 28 shtator 2023, mbajti seancë ku theksoi se për shkak të ndërrimit të gjyqtarit, shqyrtimi në këtë çështje fillon rishtas, dhe aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për precizimin e padisë. Gjykata Themelore, pas këtij veprimi, më 9 dhe 30 tetor 2023, mbajti seancat e radhës, por pa vendosur ende lidhur me çështjen. Për më tepër, Gjykata nga përgjigjja e Gjykatës Themelore vëren se Gjykata Themelore kishte vendosur lidhur me rastin në fjalë tek më 5 prill 2024.

70. Duke pasur parasysh të lartcekurat si dhe veprimet procedurale të ndërmarra nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata thekson se përgjegjësia për zvarritjen e lëndës nuk mund t'i atribuohet në këtë rast sjelljes së parashtruesit të kërkesës, por Gjykatës Themelore, e cila pa ndonjë arsye konkrete nuk kishte arritur për kaq kohë që të vendosë lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës. Thënë këtë, dhe duke marrë për bazë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se Gjykata Themelore si rezultat i moscaktimit të seancave apo mosmbajtjes së seancës përgatitore apo edhe shtyrjeve të seancave si pasojë e organizmit të brendshëm të saj, ose ndërrimit të gjyqtarëve të rastit, kontribuoi në zvarritjen e vendimmarrjes për këtë çështje, që përfshin periudhën kohore deri në prill 2024, e cila periudhë ka rezultuar në stërzgjatje të procedurës pranë Gjykatës Themelore për më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vite.

iv) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest

71. Lidhur me këtë, Gjykata ka sqaruar kategoritë e caktuara të rasteve të cilat, për nga natyra e tyre, duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Çështja e parashtruesit të kërkesës jo domosdoshmërisht hyn në atë kategori.

72. Thënë këtë, Gjykata thekson se nuk mund të konsiderohet e arsyeshme një periudhë kaq e gjatë kohore për zgjidhjen e një rasti të tillë pranë Gjykatës Themelore, pavarësisht natyrës së rastit. Gjykata konsideron se stërzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë është e papranueshme në rrethanat e rastit konkret dhe si e tillë është në kundërshtim të plotë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së.

73. Si përfundim, Gjykata, marrë parasysh aplikimin kumulativ të kritereve të lartcekura, konstaton se: (i) megjithëse rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest të kompensimit, nuk rezulton të jetë i një natyre aq të ndërlikuar saqë do të mund të justifikonte që procedura gjyqësore për zgjidhjen e kontestit përkatës të mos përfundojë as për më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vjet; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës përmes veprimeve të tij, por vetëm ka ndjekur hapat proceduralë për realizimin e të drejtës së tij për kompensim lidhur shtesën në pagë; ndërsa (iii) Gjykata Themelore për më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vjet nuk ka zgjidhur rastin e tij, si instancë e parë gjyqësore.

74. Rrjedhimisht, edhe pse Gjykata Themelore ka vendosur lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës për shkak të tejzgjatjes së procedurës, Gjykata Themelore ka shkelur të drejtën e tij për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

75. Gjykata vlerëson se, pas konstatimit të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, është e domosdoshme që gjykatat e rregullta, përfshirë Gjykatën e Apelit, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për trajtimin dhe përmbylljen e kësaj çështjeje me prioritet dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor. Kjo duhet të bëhet

në pajtim me gjetjet e këtij Aktgjykimi, duke respektuar pavarësinë e plotë të gjykatave në procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes lidhur me lëndën përkatëse.

Përkitazi me kërkesën për kompensim

76. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar edhe që Republika e Kosovës t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro "*në emër të dhimbjeve shpirtërore*".

77. Lidhur me këtë, Gjykata ka ripërsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNj-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih rastet: KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lart, paragrafi 115; KI06/21, cituar më lart, paragrafi 84; dhe KI64/23, cituar më lart, paragrafi 104; KI142/23, parashtrues Fadil Berisha, Aktgjykim i 18 marsit 2025, paragrafi 68).

78. Gjykata përsërit se, në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të "*shpërblimit të drejtë*", sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësojë një dëm jomaterial. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih rastet e Gjykatës: KI113/21, parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, paragrafët 145-151; dhe KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, cituar më lart, paragrafi 85; KI142/23, parashtrues Fadil Berisha, cituar më lart, paragrafi 69).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 3 shtator 2025, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;

IV. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Remzije Istrefi-Peci Nexhmi Rexhepi